

# **Punëkërkesit me Aftësi të Kufizuara**

**U d h ë z u e s**

# Përmbajtja

---

Qëllimi i Udhëzuesit

Rëndësia e punësimit për personat me aftësi të kufizuara

Pengesat dhe problemet me të cilat përballen personat punëkërkues me aftësi të kufizuara për punësim

Personat me aftësi të kufizuara në proces për kërkimin, gjetjen e ruajtjen e një vendi të përshtatshëm pune.

Disa problematika specifike që duhet të konsiderohen gjatë procesit të nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

- Bërja publike e një aftësie të kufizuar

- Akomodimi i arsyeshëm

## Qëllimi i Udhëzuesit

---

Ky udhëzues synon të ndihmojë njerëzit me të gjitha tipet e aftësisë së kufizuar në të gjitha hapat e një procesi punësimi - për të përmirësuar aftësitë e tyre për të kërkuar punë, për të kaluar një proces rekrutimi, për t'u përshtatur në mjedisin e ri të punës, për t'u pajisur me informacione për të demonstruar aftësitë e tyre dhe për të mbajtur një vend pune.



# Rëndësia e punësimit për personat me aftësi të kufizuara

---

## ***A munden dhe a duan të punojnë personat me aftësi të kufizuara?***

Shpesh supozohet se personat me aftësi të kufizuara nuk mund ose nuk do të duan të punojnë. Kjo është e gabuar - personat me aftësi të kufizuara, ashtu si edhe personat pa aftësi të kufizuara, duan të punojnë dhe nëse u jepen mundësi, ata punojnë. Aftësia e personave me aftësi të kufizuara për punë - pavarësisht nëse aftësia e kufizuar është e lindur apo e fituar më vonë në jetë - është e lidhur ngushtë me shkallën në të cilën ata janë në kushtet e aftësisë së kufizuar dhe se sa janë në gjendje të jetojnë të pavarur.

## ***Pse dëshirojnë dhe pse kanë nevojë të punojnë personat me aftësi të kufizuara?***

*Sigurojnë jetesën* - Puna siguron të ardhura për personat me aftësi të kufizuara për të përmbushur nevojat e tyre themelore. Puna siguron mjetet për të përmbushur shpenzimet shtesë që lidhen me të qenurit me aftësi të kufizuara.

*Gëzojnë kontakte sociale* - Personat me aftësi të kufizuara kanë mundësi të kufizuara për të takuar njerëz. Puna ofron mundësi të tilla. Njerëzit me aftësi të kufizuara kuptojnë dhe ndjejnë se të paturit e një pune redukton mërzitjen dhe vetminë. Mospasja e një pune e përforcon izolimin social.

*Fitojnë dhe rrisin vetëbesimin* - Puna, veçanërisht punësimi i paguar, u jep personave me aftësi të kufizuara një mundësi për të treguar se ata mund të kontribuojnë. Njerëzit me aftësi të kufizuara tregojnë se si puna ndërton qëndrime pozitive. Atyre që janë pa punë u mungon krenaria dhe besimi në aftësinë e tyre.

## ***Me se janë të lidhura pengesat dhe problemet me të cilat përballen personat punëkërkues me aftësi të kufizuara për punësim?***

Puna është burim mirëqënieje për njerëzit me aftësi të kufizuara. Por ata përballen me pengesa në gjetjen dhe mbajtjen e punëve. Këto pengesa mund të jenë: a) të lidhura direkt me aftësinë e kufizuar të tyre; b) të lidhura me mjedisin në komunitetet dhe vendbanimet e tyre.

# Pengesat dhe problemet me të cilat përballen personat punëkërkuar me aftësi të kufizuara për punësim

---

***Cilat janë pengesat me të cilat përballen personat punëkërkuar me aftësi të kufizuara për punësim?***

## **Pengesat përfshijnë:**

- qëndrimet negative, shpesh të lidhura me diskriminimin
- qasje të pabarabartë në arsim dhe trajnim
- ndërtesa të paarritshme / të papërshtatura
- mungesa e informacionit të arritshëm / të përshtatshëm
- transport i paarritshëm / i papërshtatshëm
- mungesa e pajisjeve ndihmëse dhe shërbimeve mbështetëse
- vetëbesim të ulët dhe kujdesi i tepruar i familjeve
- mungesa e një mjedisi mbështetës ligjor
- mungesa e mbështetjes politike

Pengesat, që përjashtojnë personat me aftësi të kufizuara nga shërbimet dhe mundësitë që lidhen me punësimin janë sociale, ekonomike, kulturore dhe politike. Këto pengesa janë reale, por të gjitha mund të kapërcehen.

***A është i mundshëm arsimimi dhe formimi profesional për personat me aftësi të kufizuara duke qënë një nga elementet e domosdoshem për punësimin e tyre?***

Fëmijët me aftësi të kufizuara, në varësi të llojit të aftësive të kufizuara, i kanë të kufizuara mundësitë edukative, për shkak të barrierave mjedisore e të qëndrimeve me të cilët ata dhe familjet e tyre përballen, më të theksuara këto në zonat rurale. Për personat me aftësi të kufizuara shpesh janë të pa arritshme edhe kurset e trajnimit profesional, për shkak të mungesës së mjediseve, mjeteve dhe shërbimeve të përshtatura për ta.

***A është gjithmonë efektiv trajnimi profesional për punësim?***

Personat me aftësi të kufizuara, që arrijnë të trajnohen, ashtu si edhe personat pa aftësi të kufizuara, mund të trajnohen në specialitete për të cilat nuk kanë mundësi punësimi në zonën ku banojnë, që mund të rezultojë që të mos gjendet punë apo të gjenden ato me nivel të ulët pagese,

të pasigurta dhe pa perspektivë. Pra duhet të kërkohen trajnime profesionale të cilat të krijojnë më pas një mundësi punësimi.

### ***Si ndikojnë ndryshimet teknologjike në punësimin e personave me aftësi të kufizuara?***

Ndryshimet teknologjike ndikojnë pozitivisht në punësimin e tyre. Punët e ofruara përmes internetit u ofrojnë disa personave me dëmtime në lëvizje mundësinë për të punuar nga shtëpia, duke reduktuar problemet e transportit, aksesit dhe lodhjes. Teknologjia e informacionit ofron një mundësi për personat me aftësi të kufizuara, të cilët kanë vështirësi në frekuentimin e qendrave të trajnimit, për të mësuar në shtëpi.

### ***Si janë qëndrimet dhe perceptimet e punëdhënësve ndaj punëkërkesve me aftësi të kufizuara?***

Personat me aftësi të kufizuara shihen shpesh nga punëdhënësit si të papërshtatshëm për punësim. Që qëndrimet e punëdhënësve të ndryshojnë, është e nevojshme t'u sigurohen punëdhënësve informacione të reja dhe mundësi për të diskutuar që të reflektojnë mbi punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara.

### ***Sa i sigurt është procesi i punësimit për personat me aftësi të kufizuara?***

Siguria e punësimit për punëtorët me aftësi të kufizuara është shpesh më pak se për punëtorët që nuk kanë aftësi të kufizuara, ata mund të jenë të parët që humbasin punët e tyre në rast të vendeve të humbura. Ka situata në të cilat personat me aftësi të kufizuara janë të penguar nga ligji që të lidhin kontrata pune.

### ***A ka kosto më të larta për të punësuarit me aftësi të kufizuara?***

Edhe pse ka një punë që siguron përfitime reale për personat me aftësi të kufizuara, ata shpesh përballen me kosto më të lartë të lidhura me punësimin, krahasuar me punonjësit e tjerë. Shembull: Përdoruesit e karrigeve me rrota shpesh kanë për të udhëtuar me taksì në vend të transportit publik që është më i lirë.



### ***Cilat janë nevojat në rastet e vetë-punësimit për personat me aftësi të kufizuara?***

Për të gjithë personat që kërkojnë të fillojnë biznesin e tyre duhen shërbime këshilluese trajnime dhe qasje në kredi dhe tregje. Por personat me aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë për më shumë shtesë për përshtatjen e pajisjeve dhe vendit të tyre të punës me nevojat e tyre të veçanta.



### ***Cilat janë probleme të veçanta për punësimin e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara?***

Mundësitë e punësimit për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të jenë të rralla. Gratë me aftësi të kufizuara përballen me diskriminim më të madh se gratë në përgjithësi. Angazhimi në punët e shtëpisë shpesh shihet si e vetmja mundësi punësimi për shumë gra dhe vajza me aftësi të kufizuara.

# Personat me aftësi të kufizuara në proces për kërkimin, gjetjen e ruajtjen e një vendi të përshtatshëm pune

---

## ***Si duhet të jetë personi me aftësi të kufizuara kur kërkon të punësohet?***

I motivuar për të kërkuar punë, duke e vlerësuar si burim të ardhurash e përmirësim të statusit social.

Realist - Shumica aspirojnë një profesion interesant me përfitime dhe një pagë të mirë. Punët e para nuk i ofrojnë këto gjëra, por ofrojnë potencialin e zhvillimit.

Analizues mbi atë se çfarë kërkon një vend pune. Pasi të njihet mjedisi i punës, është mirë të praktikohen metodat e punës për të parë nëse përshtaten me stilin e jetës së punëkërkuesit.

I qartë se çfarë presin punëdhënësit nga një punëkërkues. Të kuptuarit e pritshmërive potenciale të punëdhënësit ndihmojnë për të vendosur nëse një vend pune është i përshtatshëm dhe nëse aftësitë përmbushin pritshmëritë e një tregu konkures.

I vendosur - kjo fokuson për të filluar më tej procesin e kërkimit të vendit të punës.

## ***Ku mund të kërkohet punë?***

Personi me aftësi të kufizuara duhet të hartojë dhe përditësojë një listë të punëdhënësve të mundshëm në zonë dhe t'i kontaktojë ata drejtpërdrejt, për të marrë informacion më të detajuar mbi specifikimet e vendit të punës.

## ***Si të përgatitet një CV?***

CV-ja është mjete parësor në kërkimin e një pune dhe bën të mundur një intervistë. CV duhet të ofrojë informacion mbi pikat e forta, fakte, informacion në mënyrë kronologjike, duke e vendosur fokusin të përputhur me kërkesat për vendin e punës, të jetë e shkurtër, e thjeshtë, e saktë nga ana gramatikore si edhe të japë informacion në lidhje me eksperiencat që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar.

## ***Si të plotësohet një formular aplikimi?***

Plotësimi i një formulari aplikimi ka rëndësi të veçantë. Ai duhet të plotësohet saktësisht për çdo pyetje, duke përfshirë qartë të gjithë informacionin e duhur. Një fotokopje e formularit të plotësuar duhet mbajtur që të mund të përdoret gjatë përgatitjeve për intervistë.

### ***Si të organizohet një takim për të kërkuar punë apo për një intervistë?***

Pasi zgjidhet kompania me të cilën do të kontaktohet, duhet bërë një kontakt telefonik, duke folur qartë, përmbledhur dhe këndshëm. Përmes telefonatës të synohet të merret sa më shumë informacion dhe të sigurohet një mundësi takimi. Në takim shkohet gjithnjë me një kopje të CV të përditësuar.

### ***Ç'duhet ditur për një intervistë?***

Intervistat janë komunikim në dy kahe, midis punëdhënësit dhe nëpunësit të ardhshëm. Ka tipe të ndryshme intervistash: intervista me panel, intervista në grup, intervista të bazuara në kompetenca, teste aftësish. Është e rëndësishme të zbulohet paraprakisht lloji i intervistës të cilës do t'i nënshtrohet një punëkërkuar.

### ***Çfarë kërkon pranimi dhe mbajtja e vendit të punës?***

Pranimi dhe mbajtja e vendit të punës është një proces i gjatë bashkëveprimi me të tjerët në ekip. Kjo kërkon vullnet për të dëgjuar dhe për të marrë drejtime, ndërsa mësoni profesionin, kërkon qëndrim pozitiv, të jesh i sjellshëm dhe miqësor me të gjithë kolegët, të jesh i ndershëm dhe i duruar.

# Disa problematika specifike që duhet të konsiderohen gjatë procesit të nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara

---

## Bërja publike e aftësisë së kufizuar

### *A duhet bërë publike aftësia e kufizuar?*

Ka disa faktorë që mund të ndikojnë vendimarrjen për të bërë publike aftësinë e kufizuar, si: tipi i aftësisë së kufizuar; çështja e mbështetjes/akomodimit të arsyeshëm; përvoja e reagimeve negative ndaj bërjes publike të aftësive të kufizuara në të shkuarën, apo perceptimi se do të ketë diskriminim kur të kërkohet punësim.

Duhet të jetë një vendimarrje personale dhe të ketë një qëllim praktik ose personal.

Në fillim mund të zgjidhet të mos deklarohet aftësia e kufizuar. Megjithatë mosdeklarimi mund të jetë stresues dhe të ndikojë produktivitetin në terma afatgjatë.

### *Pse është mirë të deklarohet aftësia e kufizuar te punëdhënësi i ardhshëm apo ekzistues?*

Kjo do të ishte e dobishme se do t'u tregonte punëdhënësve burimet e ndihmës për të akomoduar nevojat e personit me aftësi të kufizuara në vendin e punës.

Krijon një pozicion më të mirë besimi kur u jepen detaje të plota rreth aftësisë së kufizuar menaxherit apo punëdhënësit.

### *Kur është mirë të deklarohet aftësia e kufizuar te punëdhënësi i ardhshëm apo ekzistues?*

Kjo mund të bëhet gjatë hapave të ndryshëm në procesin e punësimit. Gjetja e kohës së përshtatshme për të informuar një punëdhënësi për një aftësi të kufizuar duhet bërë, edhe pse është një vendimarrje e vështirë për shumë njerëz. Kjo mund të bëhet:

- Në seksionin e formularit të aplikimit që pyet përse mendoni se jeni i përshtatshëm për këtë vend pune ose që kërkon informacion nëse ju keni ndonjë nevojë të veçantë apo jo;
- Kur ftoheni për intervistim. Bëjeni këtë vetëm me një person që do të jetë pjesë e intervistës. Mund ta bëni kur takoheni për herë të parë në intervistë, ose në përfundim të intervistës;

- Kur merrni ofertën për punë, kjo është një opsion vetëm për ata që kanë aftësi të kufizuara të padukshme;
- Kur filloni punë, kjo është një fazë e rëndësishme për ata njerëz që rikthehen në punë, në një pozicion të njëjtë apo të ndryshëm, tashmë duke pasur një aftësi të kufizuar;
- Kur, pasi keni filluar punë, dalin probleme si rezultat i aftësisë suaj të kufizuar, por deklarimi i aftësisë së kufizuar në këtë fazë ka gjasa të merret në mënyrë më pak pozitive.

## **Akomodimi i arsyeshëm**

### ***Ç'duhet të dijë një punëkërkuar për akomodimin e arsyeshëm?***

Akomodimi i arsyeshëm përkufizohet si disa modifikime që bëhen në detyra, në strukturën e punës apo në vendin e punës që një nënpunës i kualifikuar me aftësi të kufizuara ta kryejë plotësisht punën dhe të gëzojë mundësi të barabarta për punësim.

Niveli i akomodimit i kërkuar për të bërë një vend punë të arritshëm për një punonjës me aftësi të kufizuara ndryshon shumë. Akomodimi duhet përcaktuar duke u bazuar rast pas rasti, por në bazë procedurash që duhen përdorur si udhëzues dhe në vazhdim të deklarimit të aftësisë së kufizuar apo të kërkesës për akomodim përmes një dialogu mes aplikantit/punëkërkuarit me aftësi të kufizuara dhe punëdhënësit.

### ***Si mund të kërkojë një individ akomodim të arsyeshëm?***

Në kohën që e përzgjedhin, individit duhet ta bëjë me dije punëdhënësin se nevojitet një akomodim gullim në punë për një arsye që lidhet me aftësinë e kufizuar. Një kërkesë mund të bëhet me shkrim apo me gojë.

### ***Kur duhet të kërkojë akomodim të arsyeshëm një individ me aftësi të kufizuara?***

Një individ me aftësi të kufizuar duhet të kërkojë akomodim të arsyeshëm në çdo kohë të procesit të aplikimit apo gjatë periudhës së punës. Kërkesa duhet bërë e ditur se, për shkak të një aftësie të kufizuar, egziston një pengesë në vendin e punës që po e pengon apo do ta pengojë atë të konkurojnë për një pozicion, apo të punojë.

*Ky botim është mbështetur financiarisht nga Agjencia e Shteteve të Bashkura për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Tiranë. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikpamjet e USAID-it.*